



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Emko” shpk

Adresa: Tirane Kashar Lagjja "Yzberisht", Rruga "Teodor Keko", Unaza e Re,
Ndertese Private 1-kateshe, Zona Kadastrale Nr.3866, Numer Pasurie 315/173

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur” në mbështetje të ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 30 si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar) kreu IV, Neni 33.

Referenca e procedures: Nr. REF-74928-10-12-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Blerje pajisje për zyrat për Bashkinë e Tiranës”.

Fondi limit: 8.333.280 (tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Brenda 4 (katër) javëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 05.11.2020

Publikime të mëparshme, (nëse zbatohet): Buletini Nr. 89 datë 19 Tetor 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, ka qënë pjesëmarrës në procedurë ofertuesi ekonomik me vlerën përkatëse të ofruar si më poshtë -

1. Operatori ekonomik “EMKO” shpk

NUIS K61424016V

Vlera e ofertës pa TVSH– 8 002 000 (tetë milion e dy mijë) lekë.

2. Operatori ekonomik “Muça” shpk

NUIS K01421002H

Vlera totale e ofertës: 0 (zero) lekë.

3. Operatori Ekonomik “BUNA” shpk

NUIS J61826501C

Vlera totale e ofertës: 0 (zero) lekë.

4. Operatori ekonomik “SHAGA” shpk,

NUIS J96822229J

Vlera e ofertës pa TVSH– 5,258,550 (pesë milion e dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë

Komisioni i Vlerësimit vendosi të s’kualifikojë shoqëritë si më poshtë vijon:

- 1. Operatori ekonomik “Muça” shpk**
- 2. Operatori ekonomik “BUNA” shpk**
- 3. Operatori ekonomik “SHAGA” shpk**

1. Operatori ekonomik “Muça” shpk u s’kualifikua për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “Muça” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik dokumentacionin e plotë ligjor e teknik dhe oferten ekonomike të kërkuar tek kriteret e veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave.

Për sa më sipër, Operatori Ekonomik “Muça” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor, teknik dhe ekonomik kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e **shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Operatori ekonomik “Buna” shpk u s’kualifikua për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “**BUNA**” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik dokumentacionin e plotë ligjor e teknik dhe oferten ekonomike të kërkuar tek kriteret e veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave.

Për sa më sipër, Operatori Ekonomik “**BUNA**” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor, teknik dhe ekonomik kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Operatori ekonomik “SHAGA” shpk u s’kualifikua per arsyet e mëposhtme:

Referuar Kërkesave për kualifikim pika **2.3.8** Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra (një copë) sipas specifikimeve teknike të dhënë në DST të cilat duhet të dorëzohen në ditën dhe orën e hapjes së ofertave pranë AK (Drejtoria e Prokurimeve), si më poshtë:

Karrike rrotulluese

Karrike pune

Etazher për zyrë

Tavolinë pune me kasatierë

Mosparaqitja e mostrave ditën dhe orën e hapjes se ofertave eshte kusht per s’kualifikim.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “SHAGA” shpk nuk është paraqitur në datën dhe orën e caktuar nga AK për paraqitjen e mostrave referuar kërkesave për kualifikim pika 2.3.8 e DST.

Gjithashtu, referuar kërkesave për kualifikim pika 2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për rezultatet e analizave dhe testimit të produktit, të lëshuara nga një laborator i certifikuar për të lëshuar certifikatat për cilësinë e produktit, Karrige: EN 1335-1:2000/AC:2002; EN 1335-2:2009; EN 1335-3:2009; EN 12521:2015, Tavolinë: BS EN 12521:2015, ose ekuivalente të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga DPA, ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë,

Operatori Ekonomik “SHAGA” shpk nuk ka paraqitur dëshmi për rezultatet e analizave dhe testimit të produktit, të lëshuara nga një laborator i certifikuar për të lëshuar certifikatat për cilësinë e produktit në përputhje me kriteret e përcaktuara në DST.

Për sa më sipër, Operatori Ekonomik “SHAGA” shpk s’kualifikohet pasi nuk plotëson kriteret për kualifikim, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

KVO vendos se shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Operatori Ekonomik “SHAGA” shpk në plotësim të kriterëve të tjera për kualifikim nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik "Emko" shpk** me adresë: Tirane Kashar Lagjja "Yzberisht", Rruga "Teodor Keko", Unaza e Re, Ndertese Private 1-kateshe, Zona Kadastrale Nr.3866, Numer Pasurie 315/173 se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 8. 002. 000 (tetë milion e dy mijë) lekë pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 18.11.2020.

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.